



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

PRISHTINA



Datë/a:	27.04.2010
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To: -	Drejtorin e Drejtoris për Inspektion - Qazim Çunaku
CC:	
Përmes/Preko/Through:	Drejtorit të SHPMSH - Agim Gashi
Nga/ Od/ From:	Inspektorët e Mbrojtjes dhe Shpëtimit: Fehmi Ahmedi Shaban Huruglica
Tema/ Subjekat/Subject:	Kërkesë për iniciimin e procedurës ligjore ndaj shpërdoruesve të pasurisë shoqërore - publike nëpër banesat shumë katëshe në territorin e Prishtinës.

Drejtoria Komunale për Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Shpëtimit, përmes Inspektorëve të Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në dy vitet e fundit, ka bërë vizita komplete të të gjitha objekteve të banimit me më shumë se katër kate në tërë territorin e Prishtinës. Këto vizita dhe inspektime janë shoqëruar nga ana e të gjithë Kryetarëve të Bashkësive Lokale të I-rë, II-të, III-të, IV-të, V-të, dhe VI-të. Në disa raste janë shoqëruar edhe nga Kryetarët e Këshillave Shtëpiak.

Me këtë rast janë evidentuar të gjitha të metat, uzurpimet dhe keqpërdorimet nëpër hyrje të ndërtesave, podrum, sipërfaqe të përbashkëta dhe sipërfaqe të tjera publike komunale. Për herë të parë pas më shumë se 30 vjet, evidentohen gati të gjitha banesat ku jetojnë banorët e qytetit, problemet që kanosin jetën dhe pasurinë e qytetarëve, mundësia e intervenimit të tyre dhe subjekte ve emergjente veqmas nëpër soliterët në Lakrishte dhe në vendet e tjera të qytetit. Në asnjë objekt të inspektuar nuk ka hidrant dhe aparate të zjarrfikjes, drita emergjente, shkallë emergjente ( për veq në 3 - 4 banesa ) podrumet të pastruara për strehim etj.

Konsiderojmë dhe vlerësojmë se Drejtoria për Inspeksion, si organ i vetëm komunal përgjegjës për çështje të uzurpimeve të sipërfaqeve publike duhet urgjentisht të marrë masa për largimin e keqpërdoruesve, mënjanimin e ndërtimeve pa leje dhe lirimimin e sipërfaqeve të përbashkëta nipër banesa.

Me qëllim të eliminimit të rreziqeve që kanosin jetën dhe pasurin e qytetarëve, luteni që urgjentisht të eliminoni pengesat që do të cekim në vazhdim:

Në Bashkësinë e I-rë Lokale janë vizituar dhe kontrolluar objektet e banimit:

A-1 dhe A-2, B-1 dhe B-2, Objekti C, Garazhat dhe Strehimorja publike në Rr. E UÇK-ës, në Rr. Rexhep Luci objektet 2,4,5,6,7 në rr. Brigadat e Kosovës - objekti nr.18 në Sheshin Zahir Pajaziti - objekti nr.2/1 dhe 2/2, në ish soliterin AVALLA - Objekti P + 11a, P + 5b, P-b-1, nr. Rr. Agim Ramadani - Objekti 54a, 54b, objekti 7 katësh i penzionerëve me dy hyrje / njëra në rr. Tringë Smajli dhe tjetra në rr. Agim Ramadani /, në Rr. Qamil Hoxha - objekti tri katesh dhe me dy kate mbindërtim në gjatësi dhe gjerësi të tërë ndërtesës në Rr. Nëna Tereze- objektet nr.40, 59 pn./ tri objekte/, nr. Rr. Hajdar Dushhi - dy objekte pa numër.

Në Bashkësinë e II-të Lokale, janë vizituar objektet e banimit në lagjen Lakrishtë- Soliteri 1,2,3,4 dhe 5 me mbi 1500 banorë, Soliterët nr. rr. Robert Dol respektivisht Soliterët nr. 1 me një hyrje, Soliteri a-1, A-2, A-3 dhe A-4, nr. Rr. Perandori Justian - Soliteri nr.1,2 dhe 3 dhe nr. Garibaldi - Soliteri nr.17.

Në Bashkësinë e III-të lokale, janë vizituar në rr. 28 Nëntori - objekti 1/1 hyrja e parë dhe dytë, objekti 1/3 hyrja I/a dhe hyrja e parë, objekti 1/3 hyrja 2,3 dhe 4, objekti 1/5-hyrja 1,2,3 dhe 4, në rr. Andon Harapi - objekti Solidariteti - hyrja e parë/ II-2/hyrja II/4, II/6/ hvrja e tretë/, II/8/hyrja e IV/ dhe hyrja II/10/hyrja e pestë/, në Rr.Sadik Zeneli-Objekti 3/2-hyrja ec, A-1, hyrja A, hyrja - g, Objekti i bashkësisë lokale një katëshe ka edhe tri kate mbindërtim, hyrja III/1, Rr.Lekë Dukagjini - Objekti III?në hyrjen e tret ka dy mbindërtime/, objekti V/2 hyrja-i, Objekti IV/2 hyrja a/1 dhe a/2, Objekti IV/IV-hyrja 1 dhe 2, Objekti IV/6-hyrja 1,2,3 dhe 4, Objekti VI/2 hyrja 1,2 dhe 3, Objekti VI/6 hyrja e parë, dytë,tretë,katërtë dhe pestë/b-1,b-2,b-3,b-4dhe b-5/, në Rr.Ilaz Kodra - Objekti V/7-hyrja e parë, e dytë,tretë dhe e katërt/, Objekti V/8-hyrja e parë, e dytë dhe e tretë, Objekti - blloku 9, Objekti VII/7-hyrja e parë dhe e dytë, Objekti VII/1 hyrja e parë/a-1/, e dytë/a/ dhe hyrja e tretë/i/, Objekti VII/2 me dy hyrje dhe me dy mbindërtime, në Rr. Bill Clinton-Objekti i blloku i V-hyrja e parë, dytë,tretë,katërtë dhe pestë, E-1, E-2/, Blloku i Parë? Te Santeja / me pesë hyrje nr.Rr.Xhemajl Mustafa - Objekti IX/1 me pesë hyrje, në Rr. Idriz Gjilani- Objekti te Kurrizi me 8 hyrje, me rreth 560 banesa dhe me mbi 3000 banorë. Gadi në secilin hyrje ka nga një mbindërtim, përveç tri hyrje të fundit që kanë nga dy kate respektivisht tri kate mbindërtim.



Në bashkësinë e katërt lokale janë vizituar Sol.1,2,3, objekti P + 8 - 1 dhe 2, Objekti P + 4-1 dhe 5, Objekti S-1 a dhe 1b, hoteli i të vetmuarve, objektet C-1,2,3,4,5,7 dhe 15, objektet A-1 deri në 7, objekti U-1 dhe objektet B-30,31 dhe 32.

Në Bashkësinë e pestë Lokale, janë vizituar: Objektet D-1 deri në D-9, Objektet U-1 deri në U-3, Objektet C-12 dhe C-13 dhe objektet private të banimit në lagjen e Spitalit.

Në Bashkësinë e gjashtë lokale janë vizituar: Objekti nr. Rr. Rifat Burxheviq me 7 hyrje dhe me 5 katëshe, objekti 7 katësh me 8 hyrje, nr. rr. Mehmet Gradica Objekti me 5 hyrje dhe nga 7 kate, Objekti me 4 hyrje dhe nga 7 kate, në rr. Major Mehmet Bushi janë vizituar 10 objekte të banimit me mbi 4 kate, n[ Rr. Hyzri Talla objekti me 6 lamella dhe secila nga tri hyrje me mbi 6 kate, Objekti me 17 hyrje me nga 6 kate. Në rr. Agim Ramadani - Lagja e Univerziteti ndodhen shtypit e ashtuquajtura të profesorve universitar dhe në anën e sipërme të rrugës janë tri objekte 4 katëshe me nga dy hyrje. Përballë konviktit të studentëve D-1 dhe D-2, A-1 dhe A-2 dhe B-1 me 4 deri 6 katëshe në rr. Qamil Bala janë vizituar 5 objekte me nga 3 hyrje të lartësive të ndryshme 7-9 kate, në rr. Armend Daci janë vizituar blloqet e banimit prej 1-8 dhe gatë të gjitha me nga 4 hyrje dhe mbi 5 katëshe. Në Lagjen Bregu i Diellit II-bloqet e bardha: objektet A-1 deri në A-23, objektet A-34, 35 dhe 36,39,40 dhe 41. Të gjitha këto objekte janë 6 dhe 7 katëshe, me një hyrje dhe dy krahë.

#### Qëllimi i inspektimit

Vlerësimi i nivelit të organizimit dhe aftësisë të qytetarëve/ banorëve të objekteve të larta të banimit/ në organizimin dhe zbatimin e mbrojtjes personale dhe reciproke në arritjen e realizimit të detyrave në pengimin e rreziqeve të ndryshme nëpër ndërtesat e banimit dhe të punës dhe objektet e tjera ku banojnë dhe veprojnë, veçmas vlerësimi i aftësisë në ofrimin e ndihmës së parë medicinale. Shuarjen e zjarrit fillestar dhe të vogël, shpëtimin nga gërmadhat, shfrytëzimin e mjeteve për shpëtim nga zjarri e të tjera masa të mbrojtjes civile dhe emergjencës.

#### Gjendja ekzistuese

A/ Karakteristikat e përbashkëta - Këto gjashtë bashkësi lokale janë ndër bashkësitë më të mëdha lokale në qytet dhe kanë numrin më të madhë të banorëve dhe të ndërtesave të banimit me më shumë se pesë katëshe. Aty janë edhe keqpërdorimet më të shumta dhe më drastike që kanosin jetën dhe pasurinë e qytetarëve dhe të cilat janë të shprehura në forma të ndryshme të mbindërtimeve, ndërrimit të destinimit të hapësirave të përbashkëta, uzurpimeve e të tjera gjërave.

Banorët e ndërtesave janë rrezikuar nga mbi ndërtimet, pa pastërtia, keqpërdorimi i sipërfaqeve të përbashkëta nga persona të papërgjegjshëm dhe tejet të rrezikshëm. Objektet e banimit janë lënë pas dore dhe për ato nuk kujdeset gati se askush. Jeta e banorëve dhe pasuria e tyre është veçmas e rrezikuar dhe në masë të madhe në objektin Kurrizi, në të cilin jetojnë mbi 3000 banorë, pes soliterët në Lakrishte me mbi 1500 banorë, objektet në Rr. Robert Doli dhe Rr. Bill Klinton. Ka edhe objekte të tjera por që janë të përshkruar në procesverbalet e inspektorëve të mbrojtjes civile.

Në asnjë objekt të banuar nuk ka hidrant funksional. Aparate të zjarrfikjes dhe veçmas shkallë emergjente/ përveq nipër 2-3 objekte në Lakrishte/. Mjetet që sigurojnë parandalimin e zjarreve dhe rreziqeve të tjera janë të shkatërruara nga dora e njeriut dhe janë të pa përdorshëm. Në asnjë objekt nuk janë bërë vlerësimet lidhur me shtypjen e ujit dhe përdorimin në rastet emergjente të rrezikimit nga zjarri.

Në asnjë ndërtesë banimi asnjëherë dhe nga askush nuk është organizuar ndihma personale dhe reciproke. Këshillat shtëpiak në të shumtën e rasteve nuk janë themeluar, por edhe aty ku ekzistojnë nuk e kryejnë rolin e vet destinues. Nga ana e bashkësive lokale nuk ka interesim dhe disponim që kjo masë e mbrojtjes civile dhe ndërmarrjes së aktiviteteve emergjente të organizohet dhe parandalohen emergjencat eventuale, veçmas në parandalimin e rreziqeve nga zjarri dhe rryma.

Liftat në të shumtën e rasteve paraqesin rrezik permanent për banorët dhe veçmas për fëmijët. Edhe kutitë e orëve të cilat në të shumtën e rasteve janë të pa mbrojtura dhe me rrezik të madh, paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve dhe veçmas fëmijëve.

Mbeturinat nëpër podrume dhe për rreth banesave janë fenomen shumë i rrezikshëm i shpërthimit të zjarreve dhe shfaqjes së epidemive të ndryshme që mund të sulmojnë fëmijët dhe të rriturit. Nëpër disa ndërtesa bashkë faktor ka ndikuar në përhapjen e zjarreve që kanë mundur të jenë katastrofal për jetën dhe pasurinë e qytetarëve/ Objekti të Santeja, Lakrishtë, Kurrizi-hyrja e parë-Dardania e të tjera/

Garazhet banesore, veçmas ajo në Rr. E UÇK-ës janë lënë nën m/shirën e matrapazëve të ndryshëm. Ato duhet urgjentisht të menaxhohen nga ana e ndonjë ndërmarrjeje të autorizuar për mirëmbajtje dhe sigurim. Nëpër këto garazhe ka shumë anomali dhe elemente që me të madhe rrezikojnë jetën e banorëve për rreth tyre. Ato nuk kanë pajisje as elemente për intervenim emergjent e lëre më që mbi atë pasuri të kujdeset dikushi.

Në të shumtën e rasteve / veçmas në objektin Kurrizi, banesat të Santeja e të tjera/ sipërfaqet e banesave janë të uzurpuara dhe është pamundësuar hyrja e mjeteve të zjarrfikjes për intervenime emergjente. Në procesverbalet tona më konkretisht janë përshkruar këto pozicione dhe vështërsi.



B/ Karakteristikat e veçanta

Gjatë vizitave të pandërprera të bëra me përgjegjësi të madhe të Inspektorëve të Mbrojtjes Civile nëpër objektet e banimit janë vërejtur dhe evidentuar një mori emergjencash që ndikojnë në sigurinë e jetës dhe pasurisë së qytetarëve.

Përveç karakteristikave të përgjithshme, do t'i cekim edhe ato të veçantat për secilin bashkësi lokale në vete.

I. NË BASHKËSINË E PARË LOKALE

Në rrethin e banesave A-1, A-2, B-1 dhe B-2 dhe C janë të vendosur mbi tri agregatë dhe dy cisterna me benzin respektivisht naftë që shërbejnë për nevojat e ndërmarrjeve të ndryshme. Agregati me fuqi të madhe i Kompanisë Siguria i vendosur në mes dy hyrjeve të Soliterit A-1 paraqet shqetësim të madhë për banorët e kateve të ulëta të këtyre hyrjeve dhe gjithmonë është rrezik potencial për shëndetin e banorëve. E njëjta gjë vlenë edhe për agregatët e Ministrisë për Kulturë dhe Kryesisë së LDK-së.

Në hyrje të soliterit A-2 podrumi është i mbushur me mbeturina kurse mes kati është i mbyllur me dyer të hekurta dhe i mbushur gjithashtu me mbeturina. Para një kohe në këto sipërfaqe ka patur shpërthim të një zjarri. Pronari i këtyre dyerve është urdhëruar që ato të lirohen sa më parë dhe sipërfaqja të pastrohet sipas udhëzimeve tona.

Në Teracën e Soliterit A-2 Kompania e sigurimit Siguria ka montuar një numër të madhë kabllosh.rryme që paraqesin rrezik potencial për fëmijtë e banesave në Teracë.

Në hyrje të objekteve B-1 dhe B-2 janë venë dyer të hekurta që çojnë deri tek liftat në katin e fundit. Është urdhëruar hjekja e tyre.

Në hyrje të Platosë - Teracës të objekteve B-1 dhe B-2, që është paraparë për fëmijë, nga një banorë është montuar gypi nga i cili rrjedhin mbeturina të kanalizimit që paraqesin rrezik për shfaqjen e epidemive të ndryshme. Në këtë plato ka mbeturina të hedhura nga privatistët e dugojave poshtë teracës.

Në po këto objekte nga një banorë është uzurpuar sipërfaqja e përbashkët prej 68 metrash katror.

Garazhet në Qafë me sipërfaqe prej 10.000 metra katrorë me mbi 250 garazha janë nën menaxhimin e një matrapazi/ Arif Morina/, që nuk paguan kurrfarë kontributesh dhe nuk jep kurrfarë përgjegjësie. Nuk bënë mirëmbajtjen e sipërfaqeve dhe nuk përgjigjet për sigurinë e sipërfaqeve të uzurpuara. Sipërfaqja është rrezik potencial për sigurinë e banorëve të soliterëve A-1 dhe A-2.

Në suaza të sipërfaqeve të Garazheve punon pa kurrfarë leje pune dhe një auto larje që rrezikon daljen emergjente të garazheve.

Strehimorja kolektive në afërsi të lokaleve të Kryesisë së LDK-së është rrethuar me tela hekuri, kurse hyrja është bllokuar dhe nuk ka qasje në të.

Në Rr. Brigadat e Kosovës, në objektin nr.18, në hyrje të sajë, është ndërtuar një objekt për shitjen e CD-ve dhe sipas zyrtarëve të bashkësisë së parë lokale ai vend është uzurpuar dhe ndërtuar pa lejen dhe dijen e banorëve. Hapsira publike para këtij objekti është rrethuar me rrethojë të aluminit dhe janë zgjeruar lokalet ekzistuese në dëme të pronës komunale. Ngritja dhe zgjerimi tyre paraqet shqetësim të madhë për banorët e bancesave për afër dhe rreth tyre.

Në të njejtën rrugë, në Objektin P-b/1 që është gjashtë katëshe me 23 bancesa, në hyrje të objektit në anën e majtë është uzurpuar hapësira e përbashkët me rreth 8 metra katror në të cilën sipërfaqe ka venë dyer të hekurta. Po në këtë objekt është uzurpuar depoja e përbashkët.

Në Rr. Agim Ramadani në objektin nr. 54, prapa Fakultetit Juridik në të djathtë në dalje të rrugës kryesore, bancesat përdhese janë adaptuar dhe shendëruar në lokale afariste nëpër të cilat kalojnë kabllot elektrik të pambuluar dhe që paraqesin rrezik potencial për ndërtesën. Janë të montuara aparate elektrike të destinimit të ndryshëm me angazhim të dukshëm të rrjetit elektrik ekzistues.

Në rr. Qamil Hoxha, objekti përballë shtëpisë së Xhavid Nimanit, që është tri katesh, janë të mbindërtuara edhe dy kate në tërë gjatësinë e objektit.

Gjatë tërë vizitave nëpër objektet e banimit të bashkësive lokale, me Inspektorët e MC prezent kanë qenë Kryetari dhe Referenti i kësaj bashkësie me ç'rast së bashku janë definuar problemet evidente që i cekëm më lartë.

## II. NË BASHKËSINË E DYTË LOKALE

Në Soliterin nr. 1 në hyrje të podrumeve, dera e blinduar e hekurta e venë nga një banorë i hyrjes / Bekim Gashi / dhe dalja emergjente e bllokuar dhe uzurpuar me dyer të hekurta

Faqe 6 nga 11



nga i njëjti person paraqesin rrezik permanent për banorët e hyrjes. Është urdhëruar që t'i hjekë ato pengesa dhe të pastrojë sipërfaqen e uzurpuar.

Dalja për në teracën e soliterit është bllokuar me derë hekuri nga personi që jeton në hyrje të soliterit. I njëjti ka edhe një qen që shqetson qytetarët.

Banori i banesës nr.1 të soliterit Ana Bytyqi ka venë dyer të hekurta që kanë bllokuar përdheshën respektivisht dhomën e baterive dhe daljen anësore. Edhe një banor tjetër /Bajram Muharremi/ Ka venë dyer të hekurta në hyrje të shkallëve të Soliterit nr.3.

Në Soliterin nr.4 dalja anësore, në hyrje e bllokuar me dyer të hekurt nga ana e një banori /Hysen Feka/. Nga ana e tij është bllokuar edhe hyrja në podrum. Ka bllokuar edhe daljen në teracë.

Hyrja në podrum, dalja anësore dhe e rrymës që janë uzurpuar nga ana e banorit Rexhë Jahë Murati, banor i banesës nr. 22 të soliterit nr.5. Në atë sipërfaqe ka benzin, naftë, goma veturash dhe material tjetër të rrezikshëm për jetën dhe pasurin e banorëve të hyrjes.

Është bllokuar dalja për në teracë me dyer të hekurta si dhe lifti i dytë që përdoret si shpajzë nga ana e banorit Fahredin Restelica.

Ana e lindjes, përballë stacionit të autobusëve, nga ana e familjes Alshiqi është uzurpuar trotuari dhe shkallët për dalje në jug. Po ashtu, nga ana kësaj familje është bllokuar ormani i rrymës për hyrjen e parë në jug të ndërtesës / soliteri nr.1/.

Në mes të soliterëve 1 dhe 2 shkallët janë të mbyllura dhe është ndërtuar një depo nga shfrytëzuesi i Servisit të Obodinit.

Gjithë ashtu, në soliterin nr. 1 tërë podrumi me mbi 400 m<sup>2</sup> në të cilin gjinden ventilat e ujit për pes vertikale dhe ventili kryesor i kutive të hidrantëve për tërë hyrjen janë të bllokuara dhe nuk janë funksionale.

Në Jug të soliterit nr.1 është montuar baraka me llastër për auto larje me ujë të pijshëm që merrë ujë nga hyrja e parë / familja Sokoli- Ramadani nga Skenderaj dhe shfrytëzon servisin e Obodinit/. Nga këta matrapazë shtetit i janë bërë harxhime për ujë në shumë prej 18.000 €.

Nga veriu, në mes soliterëve 2 dhe 3 është uzurpuar hapësira që lidhet me trafon kryesore nga banori Ilir Kaçandolli me banesë nr.27 të soliterit 2.

Në hyrjen e dytë të soliterit nr.2 është bllokuar ormani i rrymës dhe podrumet në tërësi me dyer të hekurta. / Agim Berisha nga f. Llukar/

Në Jug të soliterit nr.2 te Trafoja e rrymës është ngritur garazha metalike që përdoret për zyre / familja Sefedin Hoxha/.

Ana e jugut në soliterin nr.3 është uzurpuar hapësira e përbashkët/ dhoma e kontejnerëve si dhe podrumi / Bajram Muharremi, banesa nr.35/.

Në mes të soliterit 3 dhe 4 është ngritur një ushqimore / tendë plastike/ që ka bllokuar hyrjet e tyre dhe që paraqet pengesë për banorët / Enver Rrahmani, rr.Tirana nr.17/.

Është uzurpuar hapësira e përbashkët që shërben për dalje nga ana e podrumit dhe hyrja në sipërfaqet e bashkësisë lokale / Agim Makovci, rr.Tirana nr.37/.

Në rrugën Bill Klinton, në soliterin A-1 është bërë uzurpimi i sipërfaqes ku ndodhen -- automatikët e liftit. Sipërfaqja është shëndëruar në depo materiali të rrezikshëm për shpërthimin e zjarrit / Arben Sopi, banor i katit ku gjindet sipërfaqja/.

Sipërfaqja e përbashkët në Soliterët A-1, A-2, A-3 dhe B-4 janë shëndëruar në lokale afariste dhe me atë rast janë ngushtuar dukshëm shkallët hyrëse ndërtesë dhe është pamundësuar veprimi emergjent i organeve emergjente.

Tërë këto uzurpime që rrezikojnë jetën dhe pasurinë e banorëve paraqesin paknaqësi të madhe të banorëve të këtyre banesave dhe kërkojnë reagim urgjent të organeve të ndjekjes dhe inspektimit.

### C. NË BASHKËSINË E TRETË LOKALE

Është ndër bashkësitë më të mëdha lokale dhe më me shumë probleme të shprehura në territorin e komunës.

Platoja përmbi Kurris në gjatësin e vet të tërësishme është në gjendje të mjerueshme dhe paraqet rrezik permanent për sigurinë e banorëve dhe qytetarëve kalimtar. Prizmat e qelqta janë të thyera, uji rrjedh pa ndërprerë.

Uzurpimet e shumta që janë bërë në tërë kompleksin e banesave në këtë Bashkësi lokale jo që paraqesin problem, por edhe në të shumtën e rasteve rrezikojnë jetën e qytetarëve - banorëve të banesave.

### C. NË BASHKËSINË E KATËRTË LOKALE



Në të gjitha objektet e banimit ka keqpërdorime prej më të ndryshmeve. Në Bulevardin e Dëshmorëve, pothuajse, të gjitha banesat në katin përdhësë janë shëndruar në lokale afariste ndërsa podrumet në depo ose lokale të ndryshme. Vend e pa vend janë ndërtuar shkallë hyrëse në hapësira publike dhe në masë kanë shëmtuar urbanistikën e rrugës.

Në sheshin Isa Boletini Soliteri 1,2 dhe 3 janë të vërshuar me kablllo të ndryshme elektrike që i japin rrugës pamje të shëmtuar dhe veçmas firmat Delta Sekuriti, Panter, dy antena të kompanive të taksive dhe një antenë e Mobtel-it. Pothuaj se në të gjitha objektet e banimit ka mbindërtime që rrezikojnë stabilitetin e tyre dhe jetën e qytetarëve, si dhe në disa podrumet janë thyer betonet e mureve mbajtëse edhe përkundër vërejtjeve tona.

Keqpërdorimi më banal dhe shumë i rrezikshëm është pompa e benzinës në mes të objekteve të banimit.

#### D/ NË BASHKËSINË E PESTË LOKALE

Karakteristikë e përbashkët e këtij territori është si në ato të bashkësive të lartë cekura: keqpërdorime të tokës dhe pronës shoqërore, mbindërtime, uzurpime.

#### DH/ NË BASHKËSINË E GJASHTË LOKALE

Objektet shumëkatëshe të banimit janë ndërtim relativisht i ri dhe në gjendje të mirë. Edhe këtu karakteristikë janë mbindërtimet, pothuajse në të gjitha objektet e banimit, përveç në lagjen Bregu i Diellit II- banesat e bardha. Hapësirat e përbashkëta. Korridoret dhe sipërfaqe të ngjashme në të shumtën e rasteve janë uzurpuar dhe keqpërdorur për qëllime të ulta private, duke mos çarë kokën për vërejtjet e organeve të pushtetit lokal. Ambienti përreth ndërtesave është në gjendje të mjerueshme. Dritat publike dhe ato të korridoreve janë të dëmtuara dhe të lëna pas dore.

#### 1. Keqpërdorimet

- Objektin I/1, në të majtë të hyrjes hapësira e përbashkët 2,5x2,5 m<sup>2</sup>, si dhe sipërfaqja e përbashkët e shëndëruar në garazh- në të njëjtin objekt janë uzurpuar podrumet dhe shëndëruar në banes/ lsmet Retkoceri/.
- hapësira në objektin e njëjt, para kutisë së orëve të rrymës, në sipërfaqe prej 10 metrash/ Shefqet Gashi/.
- Në objektin I/3, hyrja e par, podrumet e uzurpuara dhe shëndëruar në banesa,
- Në objektin Solidariteti, hyrja e parë, në hyrje të objektit, në anën e majtë dhe të djathtë gjenden marketi Hana dhe Salloni i ondulimit/ Nol Shala. Po aty, në korridor, në anën e majt hapësira prej 1,5 x 4 metra katror.

Faqe 9 nga 11

- Në të njëjtin objekt, Hyrja II/4, në të majtë të hyrjes, sipërfaqja e përbashkët është shëndruar në banesë/ Shemsi Maqedonci/,
- Në hyrjen II/6, hyrja e tretë podrumi prej 60 m<sup>2</sup> i shëndruar në lokal afarist /Bodi billding/
- Gjithë ashtu, në të njëjtin objekt, hyrja II/10, hyrja e pestë në podrum e shëndruar në Video klub,
- Në rr. Sadik Zeneli, Objekti III/2, në hyrje A-1, në të majtë, në sipërfaqen e platosë / Marketi Alvali/,
- Në të njëjtin objekt në hyrjen A, në të majtë të hyrjes sipërfaqja prej 3x2 m<sup>2</sup> ?Mini marketi dhe pronari Rrahmon Parduzi / po këtu, sipërfaqja e përbashkët dhe hyrja për në podrum është e uzurpuar dhe e mbyllur me dyer të hekurta,
- Në të njëjtin objekt, hyrja B, në të djathtë të hyrjes sipërfaqja e përbashkët i shëndruar në lokal ondulomi,
- Gjithë ashtu, në objektin e njejt - në oborr të objektit mbështetur për murin e ndërtesës është ndërtuar një objekt i shëndruar në Internet kafe / Ramadan Beshiku/,
- Në Rr. Lekë Dukagjini, në objektin V/2, gati në të gjitha katet dalja emergjente është bllokuar me dyer dhe pengesa të ndryshme,
- Në objektin IV/2, hyrja A/2, pasazhi në hyrje dhe hapësira e përbashkët për terjen e teshave e uzurpuar / Riza Gashi dhe Fahri Dragusha/.
- Në objektin VI/2, hyrja e parë hapësira e destinuar për grumbullimin e mbeturinave e shëndruar në lokal afarist,
- Objekti VI/6 hyrja e parë/h/. Në të dy anët e hyrjes hapësirat e përbashkëta, kurse në të djathtë të hyrjes dalja emergjente e shëndruar në lokal afarist / Salloni i ondulimit/Shaip Llapashtica nga Shajkoci/.
- Në rr. Iljaz Kodra, objekti VII/1 hapsirat e përbashkëta të shëndruara në kafe bar Luli. Afër këti lokal, hapësira e përbashkët i shëndruar në lokal tregtar / Ajet Ajeti/. Në të njëjtin objekt, hyrja e dytë, në anën e djathtë të hyrjes hapësira e përbashkët / Salloni i ondulimit Alma/.
- Në rr. Bill Klinton, objekti-blloku i V me tri hyrje dhe në tërësi të të gjithë hyrjet, hapësira nën ballkonet iu kan bashkangjitur lokaleve ekzistuese,
- Blloku i parë te Santeja, në të gjitha hyrjet e lira nën ballkona iu janë bashkangjitur lokaleve ekzistuese. Kjo dukuri është shumë e shprehur në anën e majtë të objektit për rrethë kafiterive.
- Rr. Xhemajl Mustafa, objekti IX, në hyrjen e pestë në përdhësë, hapësira e përbashkët e shëndruar në lokal afarist Agjencioni Gjeravica turs,
- Në hyrjen e 11 të të njëjtit objekt Kurrizi, hapësira në mes hyrjes 9 dhe 11 e shëndruar në lokal afarist - Avokaturë,
- Në hyrjen e 15, në të majtë banori me mbiemër Statovci është duke thyer betonin masiv dhe hapsirën është duke e shëndruar në lokal afarist edhe përkundër protestave të banorëve. Thirrret në dokumentacionin dhe lejen e organeve komunale të cilat nuk i kemi parë,



- Në hyrjen e 17, në të majtë poshtë sipërfaqja e përbashkët 10 x 10 metra është shëndruar në Auto larje.

2. Mbindërtimet,

- Rr. Sadik Zeneli, objekti III/2, hyrja A-dy mbindërtime,
- Hyrja II e të njëjtit objekt - dy mbindërtime,
- Objekti i Bashkësisë lokale - tri kate mbindërtim,
- Rr. Lekë Dukagjini, objekti IV/4-dy kate mbindërtim
- Hyrja e IV e të njëjtit objekt - një mbindërtim
- Objekti VI/6. në hyrjen e parë - një mbindërtim.
- Rr. Iljaz Kodra, objekti VII/1 një mbindërtim,
- Objekti VII/2 në anën e majtë të hyrjes së parë - një mbindërtim,
- Rr. Idriz Gjilani, objekti Kurrizi, në hyrjen e parë një mbindërtim. Në hyrjen e 11, në anën e djathtë të hyrjes - një mbindërtim.
- Në hyrjen e 13 të objektit Kurrizi dy kate mbindërtimi,
- Në hyrjen e 17 Kurrizi në nivelin e dytë tri kate mbindërtim,
- Përballë Kurrizit dhe Platosë ndërtesa dy katëshe ka dy mbi ndërtime /Tomë Gashi/.

Në Prishtinë,  
29.04.2010

Inspektorët e MSH,  
1. Fehmi Ahmedi, Prof.  
2. Shaban Huruglica Prof.